

Aroma e luleve



Shoqata

Fladi

Titulli: Aroma e luleve

Autori: Vullnet Merja

Kompjuteri: Sabrie Feza

Kopertina: Tahereh Ghorbani

Shtëpia Botuese: Emal



Shoqata

Fladi

BISMILAHİ RRAHMANİ RRAHİM

Parathënie

Falenderimet i takojnë vetëm Allahut i Cili ka zbritur sheriatin, na ka sqaruar rrugën, na nxorri prej errësirave në dritë dhe na urdhëroi që të ndjekim udhëzimet e Profetit Muhamed (s.a.s), *(sepse ato janë udhëzimet më të përsosura)*, të zbatojmë synetin e tij, sepse syneti i tij është më udhërrëfyesi.

Të shumta janë synetet e Profetit të



*Shumta
Alladi*

cilat nuk praktikohen. Jo vetëm kaq, por shumica e muslimanëve i zëvendësuan këto synete në ato vepra që janë të pakta në vlera. Allahu (xh.sh) thotë: **(A doni të nderoni atë që është më e pakët si dhe mustahabat)** *(vepra të pëlqyera)*, sepse këto nuk gjenden vetëm në librat kryesorë dhe në burime të kufizuara, të cilat janë të vështira për të shumtën e njerëzve për sa i përkët fjalëve dhe fjalive. Për këtë ishte e domosdoshme zgjedhja dhe sqarimi i disa prej atyre syneteve, shpresojmë që misioni i ringjalljes së sunetit të jetë i



*Shaqiqat
Alladi*

vazhdueshëm nga ana e vëllezërve të tjerë musliman të cilët mbartin ndienjëne përgjegjësisë në drejtim të fesë së Allahut (xh.sh). Profeti në një prej thënieve të tij ka thënë: *“Ai që e ringjall sunetin tim është sikur më ringjall mua dhe kush më ringjall mua do të jetë me mua në xhennet”!*

S'ka dyshim, se ai që kërkon rrugën e Allahut (xh.sh) duhet patjetër të paiset me moralet e të Dërguarëve të Tij në përgjithësi, dhe me moralet e Profetit Muhamed (s.a.s) në veçanti, si dhe me moralet e njerëzve të mirë .Suretu Ali Imran 68.



Alladi

Kush është Muhamedi (s.a.s)?

Kjo pyetje ka qenë dhe vazhdon të jetë në brendësi të njerëzve qofshin dashamirës apo urryes të H. Muhamedit (s.a.s) dhe asnjëri nuk



Shalladi

është shfaqur e të thotë se i është përgjigjur kësaj pyetje në mënyrë bindëse dhe të pranueshme. Edhe ai person i cili përfytyron se i është përgjigjur kësaj pyetje, mirëpo të tjerët e shohin se është i gabueshëm në përgjigje.

H. Muhamedi (s.a.a) nuk është person i panjohur që të ketë nevojë për njohje, sepse Ai është më i njohuri i njerëzve që ka parë toka që kur u bë e përshtatshme për jetesë, mirëpo atij nuk i është prezantuar njohja ashtu siç i takon dhe për këtë qëndron pyetja "Kush është Muhamedi?". Kjo përshkak se



Alladi

mendja e njeriut nuk ka arritur në atë lartësi që mund të kuptojë pozitën e atij personaliteti të përsosur e udhërrëfyes.

Ai person, i cili përpiket të japë përgjigje rreth kësaj pyetje, ai nxjerr në pah sasinë e njohjes së tij për këtë person të famshëm. A ka mundëi që një person të jetë në gjendje të kuptojë atë i cili arriti në majat e përsosmërisë njerëzore?

Ata që thonë se H. Muhammedi (s.a.a) është njeriu më i "*përsosur*" dhe udhërrëfyes i njerëzisë, a kuptojnë thelbin e fjalës "*njeri i përsosur*"?



Shamela
Alladi

Ska dyshim se, njohja e profetit Muhamed (s.a.a) shtë plotësuese dhe ndriçuese për mendjen e njerëzisë. Të shumta janë kërkimet dhe studimet e kërkuesve dhe studiuesve rreth jetës së profetit Muhamed (s.a.a) duke filluar që në kohën e tij e duke ardhur në ditët e sotme gjë e cila do të vazhdojë edhe në të ardhmen .

Ai (s.a.a.) nuk është i veçantë për një komb e as për një kontinent, por ai është i dërguar për të gjithë njerëzinë (*e pranojnë apo e kundërshtojnë*). Ai nuk është i veçantë vetëm për muslimanët, por ai është



Alladi

për të gjithë njerëzinë siç e vërteton Kur'ani Famëlartë i cili thotë: **(Ne të dërguam ty për të gjithë njerëzit).**

Sure Sebe ajeti 27. Cilido që studion jetën e profetit Muhamed (s.a.a) si dhe kushtetutën që ai solli, do të shohë se edhe kombet e tjera jo islame janë lumturuar me Muhamedin (s.a.a) ashtu si muslimanët. Të gjithë të dërguarit e Allahut kanë qenë në shërbim të njerëzisë, ata u përpoqën dhe sakrifikuan me qëllim që njerëzit të jetonin të lumtur, mirëpo profeti Muhamed (s.a.a) ka qenë më i larti i tyre kundrejt shërbimit të njerëzisë.



Alladi

Ai ka qenë më i përsosuri i tyre si dhe vula e tyre dhe se nuk vjen i dërguar pas tij siç e dëshmon Kur`ani Famëlartë në suren Ahzab ajeti 40: **(Muhamedi nuk ka qenë baba i asnjërit prej burrave tuaj, por i dërguari i Allahut dhe vula e të dërguarve).**

Profeti Muhamed (s.a.a.) solli kushtetutën e jetës, solli mësimet me anë të cilave shpëtoi njerëzinë prej shtypjes dhe nënshtrimit në kohën që ishin në buzë të greminave errësuese. Kjo kushtetutë është Kur`ani Famëlartë, të cilit nuk i vjen asnjë e kotë, sepse është vetë



Alladi

Allahu, Ai që ruan dhe e mbron atë.
Po ashtu, është edhe interesimi i muslimanëve, të cilët e nderojnë, e respektojnë dhe zbatojnë rregullat dhe ligjet që ai përmban. Sheriati që solli H. Muhamedi (s.a.a.) është e bashkangjitur plotësisht me ligjet e natyrës dhe çdo ndjje i jep atë që i takon po ashtu ai është edhe tolerant. Para ardhjes së profetit Muhamed (s.a.a) bota ishte trup pa shpirt dhe e tëra errësirë dhe Muhamedi (s.a.a.) solli shpirt për botën dhe gjallërim për atë tokë të vdekur. S`ka dyshim se, vetë H.Muhamedi (s.a.a.) është shpirt për



Alladi

botën dhe diell me anë të cilit ndriçohet mendja njerëzore. Mos ishte Muhamedi (s.a.a.) dhe sheriat i tij në këtë botë nuk do të shihej veçse shtypje, padrejtësi, degradim, nuk do të shihej lumturi e as begati qofshin individuale apo shoqërore. Ai (s.a.a.) ftonte në dituri dhe vetë ishte i pashkolluar. A është parë që një i pa shkollë të luftojë injorancën? Profeti Muhamed (s.a.a.), nuk studioi në universitete, as nuk ka marrë mësim nga mësuesit, as nuk ka marrë pjesë në simpoziume shkencore, as nuk u rrit në një ambiente dieje, por ai u rrit në një



Alladi

shoqëri të cilën e mbulonte padituria, hija e fanatizmit dhe mendjemadhësisë.

Edhe Kur'ani na flet për qënien e profetit Muhamed i pashkolluar(.....).

Ky i pashkolluari është vetë mrekulli, mrekulli në diturinë e tij, mrekulli në virtytet e tij, mrekulli në mendimet e tij, mrekulli në faljen e tij, mrekulli në urtësinë e tij, mrekulli në trimërinë e tij, mrekulli në cilësitë dhe përsosmëritë e tij. E sa e sa të shumta janë mrekullitë në këtë personalitet kaq të famshëm!



Shahada
Alladi

Allahu fuqplot në Kur`anin e Famëlartë thotë: (Vërtet ju tek i dërguari i Allahut keni shembullin më të lartë). Ahzabë-21

Profeti Muhamed, mëshirë për krijesat.

Gabon rëndë ai që thotë se feja islame është përhapur me gjuhën e shpatës, sepse po të studiojmë Kur`anin e Famëlartë do të gjejmë se:

Së pari: Dhuna nuk është e pranueshme në fe siç thotë vetë Allahu (xh.sh) (në fe nuk ka dhunë...



Alladi

Bekare-256, (fto në rrugën e Zotit tënd me urtësi dhe porosi të përkryera).

Së dyti: Është shumë e qartë nga ë gjithë se fitimi i zemrave nëpërmjet dhunës është e pamundur, prandaj nuk ndodhet mënyrë tjetër përveç urtësisë, dashamirësisë dhe këshillave.

Nëse i hedhim një vështrim jetës së Profetit Muhamed (s.a.a.) do të shohim se veprimi i parë që ai kreu ishte pastrimi dhe edukimi i zemrave dhe ky veprim është i pamundur të arrihet me anë të dhunës dhe forcës. Arma më e fortë për mposhtjen e armiqëve ishin morali i



Alladi

lartë dhe mëshira e gjërë. Për këtë profeti u quajt

" *Profeti i mëshirës*" për të afërmit dhe për të largët, për miqtë dhe për armiqtë. Allahu në Kur'an thotë (**Ne të dërguam ty mëshirë për të gjitha krijesat**).Enbija-107.

Ai (s.a.a.) i kishte të gjitha mundësitë për përdorimin e dhunës në kohën që ishte në Mekë. Sikur t'i urdhëronte shokët e tij për asgjësimin e kundërshtarëve të tij në një natë ai do t'ia arrinte kësaj gjëje. Nëse e bënte, nuk do të sprovonte keqbërjet e as nuk do të shijonte fatëkeqësitë, sepse



Shayata
Alladi

drejtuesit e keqbëbersve të tij ishin sa numuri i gishtërinjve, por ai nuk e bëri këtë, sepse ishte dërgues i mëshirës. Ai kurrë nuk e ka ngritur shpatën mbi ata, vetëm kur ata i ngritën shpatat kundra tij, nuk ka përdorur gjuhën e armës vetëm pasi ata e përdorën atë kundra tij.

Nëse do të kishte përdorur gjuhën e forcës nuk do gjendej ky numur kaq i madh pasuesish të tij. Këtë gjë e dëshmon edhe Kur'ani Famëlartë i cili thotë: **(Ti ishe i butë ndaj tyre e allahu të dhuroi mëshirë, sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë ata do të largoheshin nga ti....Ali Imran-159.**



Alladi

Nëse lexojmë dhe studiojmë jetëshkrimin e profetit Muhamed (s.a.s) do të gjejmë shumë ndodhi armiqësore që i kanë ndodhur profetit dhe ai u është kundërpërgjigjur me butësi e mëshirë. Ndër ato ndodhi përmendim: Një grua jahudite donte ta helmonte profetin. Për realizimin e planit të saj ajo e ftoi Profetin sëbashku me disa shokë të tij për gosti në shtëpinë e saj . Por, Allahu (xh.sh.) e mbrojti prej këtij kurthi dhe e zbuloi sekretin e saj. Profeti (s.a.s) e fali atë grua për këtë gjest dhe nuk e ndëshkoi. Ndienja e thellë e



Alladi

mëshirës që ndodhej tek Profeti Muhamed (s.a.s) u shfaq në kohën e çlirimit të Mekës i cili tha atë thënie të përsosur kur mekasit e pyetën se çfarë do të ndodhte me ata në këtë kohë. Ai (s.a.s) i tha atyre: "*Shkoni, ju jeni të lirë*". Mendoni të nderuar lexues, a ndodhet në rruzullin tokësor person sado me famë të jetë që t`i thotë armiqëve të tij më të ashpër të cilët e torturuan, e poshtëruan me lloje të ndryshme fjalësh, e luftuan për njëzet e tre vjet me rradhë, e si përfundim t`i thotë ju jeni të lirë? Pra ky është Profeti Muhamed (s.a.a.) të cilit nuk i



Shahada
Alladi

ngjason askush për nga ana shpirtërore. A nuk duhet respektuar ky personalitet? A nuk duhet të mësohen e të ndiqen këshillat dhe porositë e tij? Sigurisht që po, sepse në dashurinë, respektimin dhe ndjekjen e tij ndodhet kënaqësi dhe qetësi për zemrat. Po ashtu, në dashurinë dhe në ndjekjen e rrugës së tij ndodhet kënaqësia e Allahut (xh.sh). Kur'ani Famëlartë thotë: **(Thuaj: më ndiqni mua e Allahu tu dojë juve).**

Pra, përderisa udhëheqësi i kësaj feje është i tillë atëhere si do të jetë vallë feja e tij? S`ka dyshim se feja e



Alladi

tij është fe e paqes, e mëshirës, e faljes, e vëllazërimit, e bujarisë, etj. Në fenë islame nuk ekziston urrejtja, as padrejtësia, as poshtërimi e as pabarazia, sepse, Profeti Muhamed (s.a.s) ishte ai i cili e zhdukuri racizmin dhe luftoi fanatizmin. Në një thënie të tij thuhet : " *Nuk ka dallim në mes arabit e joarabit me përjashtim të devotshmërisë*".

Profeti Muhamed (s.a.a.) ishte ai, i cili bëri thirrje për drejtësi si dhe vendosi të drejtat e gruas dhe se ajo është njeri si mashkulli.



Shahada
Alladi

Profeti Muhamed (s.a.a.) ishte ai i cili i porosiste prijësit e ushtrive para se të niseshin për në betejë duke i thënë: *Mos vritni të moshuarit, as fëmijët e as gratë. Mos i pritni pemët. Mos i masakroni të plagosurit. Mos digjni shtëpitë e mos i plaçkitni ato.....*". Ky është profeti Muhamed (s.a.a.) dhe kjo është feja e tij e cila e ndalon rreptësisht vrasjen dhe gjakderdhjen. Kur`ani Famëlartë thotë: (... ai që vret një njeri që nuk ka vrarë e as nuk ka bërë shkatarrim, është njësoj sikur të kishte vrarë të gjithë njerëzit...).



Shkruar nga
Alladi

Feja islame është fe e paqes dhe këtë e shohim që në takimin e parë në mes myslimanëve të cilët përshëndesin njëri tjetrin "paqja qoftë mbi ju". Por nëse themi se islame e ligjton dhunën me anë e xhihadit (luftës së shenjtë), kjo nuk nënkupton të thuhet se islami është fe e dhunës, sepse në juripedencën islame sqarohen më së miri kushtet e kësaj çështje. Prandaj, ftojmë të gjithë ata të cilët hedhin akuza mbi këtë fe të pastër e të larmishme që të studiojnë sa më mirë dhe larg çdo fanatizmi apo intekushtetutën bazë të kësaj feje "*Kur'anin* Famëlartë "



Alladi

si dhe jetën e të dërguarit të Allahut, vulës së profetësisë, H. Muhamedi (s.a.s), dhe, pastaj të nxjerrin konkluzionet përkatëse, sepse rrezet e diellit nuk bllokohen kurrë me shoshë. Allahu (xh.sh.) në Kur'an thotë: (Punoni, se Allahu do t`i shohë punët tuaja dhe i dërguari i Tij dhe besimtarët).

Ditëlindja e Profetit Muhamed

(s.a.s) **dita e unitetit islam.**



Shoqata

Alladi

Duke parë ç`ka thamë më lart, të cilat nuk janë veçse pikëza uji të marra nga deti i pa fund, fare mirë mund të themi se ditëlindja e Profetit Muhamed (s.a.s) është dita e unitetit të muslimanëve. Në këtë ditë muslimanët në mbarë botën festojnë ditën e lindjes së Profetit Muhamed (s.a.a.) dhe në këtë ditë ata nxjerrin mësimet për të ardhmen e tyre duke u bazuar në Kur`anin Famëlartë dhe në thëniet e porositë e të Dërguarit të Allahut (xh.sh.), i Cili në Kur'an thotë (ato çfarë iu jep i dërguari merrini dhe për ato që iu ndalon, ndaloni). Por, nuk mjafton



Alladi

që Profeti (s.a.a.) të përkujtohet një herë apo dy herë në vit, sepse edhe pse ai nuk ndodhet në mesin tonë me trup, mirëpo tek ndodhet mrekullia e tij e përhershme, Kur`ani, si dhe hadithi i tij, të cilët janë frymëzues dhe dobiprurës për çdo njeri dhe janë të pandara nga njëra tjetra. Argument mëse i qartë i unitetit të muslimanëve është dëshmia të cilën ato dëshmojnë: "*Eshhedu en lailahe il-lallah ue eshedu en-ne Muhameden resulullah*" e cila sqaron se zemrat e muslimanëve janë të drejtuara dhe të bashkuara



Alladi

në besimin tek Allahu dhe tek i dërguari i tij. Në këtë ditë të madhe të gjithë muslimanët njihen me sakrificat e Profetit, të cilat i bëri për bashkimin e zemrave që ato të përgatiten për t'i bërë ballë çdo kundërvënie që mund t'i vijë atyre, ashtu siç i bënte ballë Profeti. Jo më kot, Allahu na urdhëron e na thotë se ju tek Profeti gjeni shembullin më të lartë, sepse ai është shembull në morale ndaj të cilit Kur'ani thotë: **(Vërtet ti je në majat më të larta të moralit)**. Ai është shembull në urtësi në butësi, ku me anë të cilave arriti të bëjë bashkimin e



Alladi

zemrave dhe për këtë duhet që edhe sot e kësaj dite zemrat e muslimanëve të jenë të bashkuara dhe të kenë si qëllim vetëm, e ky është Islami. Allahu në Kur'an thotë: **(Kapuni pas fesë së Allahut e mos u ndani).**



Shoqata

Alladi

Syneti i Profetit në mardhëniet shoqërore

Prej moralit të tij përmendim:

1-Kur ecte shikimin e mbante në tokë, i cili ka qenë më i tepërt se shikimi në qiell.Kjo për shkak të modestësisë së tij në mesin e njerëzve,dhe nënshtrimit para Allahut (xh.sh)...dhe dukej sikur qëndrënte një zog mbi kokën e tij.



Shoqata

Alladi

2-Ai ishte i pari i cili përshëndeste me selam dhe këtë e bënte para çdo fjale.Kjo është shenjë e modestisë.Për atë që përshëndet i pari me selam gjenden 99 të mira dhe për atë që e kthen selamin një.

3-Nuk fliste vetëm kur ishte e mevojshme dhe e përshtatshme si këshilla,porosi,mësime,urdhërime më të mira,ndalim nga të këqijat.Nëse nuk gjin deshin këto... qëndronte në heshtje. Kurrë nuk fliste fjalë të dëshpërueshme të cilat plagosin zemrën.



Shahada
Alladi

4-Ai ishte falenderues për mirësitë dhe nuk i përbuzte ato, të shumta ishin apo të pakta, sepse të gjitha janë prej Allahut (xh.sh).

5-Ai ka qenë buzëqeshësh. Nuk qeshte me zë të lartë dhe nuk e ngrinte zërin e tij, siç veprojnë të pakujdesurit.

6-Ai thotë: Më informoni për nevojat e atij, që nuk mundet të informojë njerëzit për nevojat e tij.

7-Pyeste për shokët e tij.



Shopyata

Alladi

8-Pyeste njerëzit për ç'farë ndodhej në mesin e tyre. (Me qëllim që të ishte i njohur me gjendjen e tyre).

9-Kur ulej dhe kur ngrihej përmendte Allahun (xh.sh) (si istigfari, lutja...sepse ato ishin kefaratun për qëndrimin.)

10-Ulej aty ku mbaronte rradha e të ulurve,dhe urdhëronte për këtë.(Sepse ky veprim është më para modestisë dhe më larg prej mendjemadhësisë...Allahu dhe engjujt bënin salavat për atë derisa ngrihej).

Shoqata

Alladi

11-Bujaronte të gjithë të pranishmit me pjesën e tij.(Të mos jetë bujaria për llogari të tjerëve).

12-Cilido që shkonte për ndonjë nevojë ia plotësonte nëse ishte i mundur.Nëse nuk kishte mundesi e përcillte me fjalë të mira,bënte lutje për atë,e këshillonte,e udhëzonte...

13-Nuk ngriheshin zërat na praninë e tij,apo mbi zërin e tij...sepse,zëri i ulët është kulturë.Allahu (xh.sh) thotë: (Lukman, 19.).

14-Nuk fliste fjalë ofenduese,



Shoqata

Alladi

poshtëruese, mendjemadhësie,
urrejtëse, e as fjalë që shkaktojnë
hipokrizi.

15-Nuk ndërhynte në ato që nuk i
takobnin.

16-Kur Profeti (s.a.s) fliste të gjithë
heshtnin dhe e dëgjonin me
vëmëndje.Kur pushonte, të tjerët
flisnin me rregull duke dëgjuar
njëri-tjetrin.

17-Ai (s.a.s) nuk ia ndërprente fjalën
tjetrit dhe e dëgjonte deri në
mbarim.



Alladi

18-Ai (s.a.s) shikonte dhe i dëgjonte të gjithë njerëzit me barazi.

19-Ai ka qenë më letrari i njerëzve dhe më fjalëmbëli. Ai (s.a.s) thotë: Unë jam më letrari i arabëve, dhe se banorët e xhenetit flasin gjuhën e Muhamedit.

20-Ai (s.a.s) përdorte fjalë të përgjithshme.

21-Atë e kanë dëgjuar duke thënë: “Jam dëguar me morale të larta dhe



Shaykhata

Alladi

të bukura “saherë që shtohet morali i një personi, aq më tepër i afrohet profetit (s.a.s).”

22-Ai (s.a.s) ka qenë më trimi i njerëzve.(Shkonte atje ku njerëzit frikësoheshin,dhe më pas ata inkurajoheshin.Ai qëndronte më pranë armiqëve.)

23-Ai (s.a) ka qenë shumë i turpshëm...d.m.th.kishte turp.

24-Një ditë erdhi tek profeti një engjell dhe i tha: O Muhamed, Allahu të dërgon selam dhe thotë: Nëse don e bëj për ty Bat'han e



Alladi

Mekës grimca ari.Profeti ngriti kokën nga qielli dhe tha: “O Zot, kur një ditë ngopem të falenderoj Ty,dhe kur një ditë kam uri kërkoj nga Ti”.

25-Kur falte namaz sytë i lotonin prej frikës së Allahut derisa këto lotë lagnin mjekrën e tij të bekuar.

26-Ai (s.a.s) bënte istigfarë shtatëdhjetë herë në çdo ditë.

27-Kur ishte në vetmi (i zemëruar apo i gëzuar), Ai (s.a.s) shtonte në prekjen e mjekrës së tij.



Alladi

28-Ai (s.a.s) ulej me të varfërit dhe hante ma ata.

29-Ai (s.a.s) hante me shërbëtorët,ulej mbi tokë, takonte të pasurit dhe të varfërit,nuk përbuzte të mjerët,dhe nuk e shkëpuste dorën e tij para se tjetri të shkëpuste dorën etij,i përshëndeste të gjithë ato që priste,të varfër apo të pasur,të mëdhenj apo të vegjël.

30-Ai (s.a.s) ka qenë i përsosur në bashkëjetesë.



Moqata

Alladi

31-Ai (s.a.s) shikohej në pasqyrë dhe krihte flokët.Ai thonte:"Allahu kërkon prej robit të tij që kur të shkojë tek vëllezërit e vet të jetë i përgatitur dhe i zbukuruar".

32-Ai (s.a.s) i përshëndeste të mëdhënjtë dhe të vegjëlit.

33-Kur qëndronte në mes dy çështjeve zgjidhte atë më të ashpërën.

34-Ai (s.a.s) nuk hante i mbështetur (si modesti ndaj Zotit të tij).



Shaykhata

Alladi

35-Kur hante hante me renditje,dhe kur pinte merrte vetëm tre gllënka.Pinte një herë dhe merrte frymë duke falenderuar Allahun dhe kështu vepronte tri herë.

36-Ai (s.a.s) e përdorte dorën e djathtë për ngrënie dhe të majtën për trupin e tij.Ai e pëlqënte të djathtën në çdo punë të tij.

37-Ai (s.a.s) i shikonte të gjithë shokët e tij me shikim të njëjtë. Nuk përdorte shikim që shkaktonte plagosje dhe turpërim.



Shahadata
Alladi

38-Kur fliste ndonjë bisedë ai
buzëqeshte.lahi-rrahmani-rrahim

39-Ai (s.a.s) kur ulej drejtohej nga
kibleja.

40-Prej modestisë së tij ishte
dërgimi një të posalindur tek ai me
qëllim që të lutej për atë për mirësi.
Vendoste në prehër si rrespekt për
prindërit e tij.Ndoshta fëmija
urinonte dhe disa që e shikonin
këtë gjë bërtisnin por profeti i
ndalonte duke i thënë:"Mos e
ndërpritni fënijen derisa të
përfundojë uri nën ... pastaj
përfundonte lutjen apo vendosjen e



Alladi

emrit.Kur largoheshin njerëzit ai lante rrobat e tij.

41-Kur udhëtomte me deve, dhe shikonte një person që ecte në këmbë, ai e ftonte që të hipte.

42-Nëse një person mungonte tri ditë, pyeste për atë. Kur ishte joprezent lutej për atë, kur ishte present e vizitonte dhe nëse ishte i sëmurë, e vizitonte atë.

43-Enesi i shërbeu Profetit nëntë vjet dhe kurrë nuk i ka thënë atij: Bëje kështu, apo përse e bëre



Alladi

veprove kështu? Kurrë nuk e ka ofenduar atë (Enesin).

44-Ai (s.a.s) i thërriste të gjithëve me kunhahum si rrespekt për ata dhe se kjo gjë ishte e pëlqyeshme në zemrat e arabëve.

45-Ai (s.a.a) i rrespektonte miqtë dhe i përgatiste atyre vendin e fjejtjes.

46-Ai (s.a.s) ndiqte një rrugë kur ikte dhe tjetrën kur u kthente.

47-Ai (s.a.s) dilte mbas lindjes së diellit.



Shoqata

Alladi

48-Kur hynte në një shtëpi, rrinte praën derës.

49-Ai (s.a.s) i fliste njerëzve sipas aftësive të tyre mendore dhe ka thënë: “Ne, të dërguarit të Allahut, jemi urdhëruar ti flasim njerëzve sipas aftësive të tyre mendore.”

50-Ai (s.a.s) ka qenë shumë adhures dhe gjithmonë i lutej Allahut (xh.sh) që ta zbukuronte me morale të përsosura. Kur lute ai thoshte: “O Zot, përsose moralin tim””O Zot më largo moralet e këqia.



Shahada
Alladi

51-Ai (s.a.s) ka qenë i pajisur me muda'betu.

52-Ai (s.a.s) i fliste të gjithëve me ato që i përshtateshin. Në një hadith të transmetuar nga Zejd ibën Thabit thotë:”Kur ishim me profetin dhe bisedonim për ahiretin ai bisedonte me ne, nëse flisnim për dunjanë edhe ai po ashu vepronte, nëse flisnim për ushqimin edhe ai po për atë fliste.

53-Ai nuk shikonte aty ku duhej shikuar.



Shoqata

Alladi

54-Kur takontë një musliman i jepte dorën.

55-Për moralet e të dërguarve ai (s.a.s) ka thënë:”Morali më i pëlqyer i të dërguarve ka qenë vizitat.”

56-Prej synetit të tij ka qenë: Kur ti flasësh me një komb, mos u drejto vetëm tek një person por të gjithë prezenteve jepi pjesën e vet.”

57-Ai (s.a.s) qepte rrobat e tij dhe rregullonte sandalet e tij.

58-Ai (s.a.s) ka qenë shumë i



Shoqata

Alladi

hollësishëm në besnikëri. Në një hadith transmetohet se idërguari i Allahut e kthente gjilpërën, fjetet dhe copat e mbetura dhe nuk i nënvlesonte ato.

59-Kur i shkonte një mik, ai (s.a.s) hante sëbashku me atë dhe nuk e ndalonte ngrënin me qëllim që miku mos turpërohej dhe të mos çohet i pangopur.

60-Ai bënte dialog me Jahuditë dhe jobesimtarët duke i hedhur poshtë thëniet e tyre. Këtë gjë e ka bërë



Alladi

shumë herë.

61-Kur pyetesh për diçka nuk thotë “Jo”.

62-Kur shokët e tij shkonin tek Profeti ata uleshin në formë rrethoreje.

63-Ai nuk shikonte në ato mënëra që janë jot ë mira në dynja.

64-Kur ai (s.a.s) mërzitej prej diçkaje, strehohej tek namazi.

65-Ai e ndihmonte shërbyesin kur



Shoqata

Alladi

ku i fundit lodhej.

66-Ai e përgatiste vetë ujin e abdesit që në darkë dhe nuk e kërkonte prej askujt këtë gë.

67-Ai ndihmonte në punët e shtëpisë.

68-Ai nuk e nguliste shikimin e tij në fytyrën e asnjë personi.

69-Ai ^(s.a.s) vishte unazë argjendi në gishtin e dorës së djathtë, përdorte misvak në abdes, shoqëronte zhenazetë dhe vizitonte të sëmurët edhe sikur të ishin në ekstrem të



Shamata
Alladi

Medines.

70-Ai rrespektonte mbartësit e e virtyteve të pëlqyera dhe kërkonte të falur.

71-Ai (s.a.s) ka qenë më i buzëqeshuri i njerëzve.

72-Prej moralit të tij ka qenë se kur një person ulej oranë tij dhe ai ndodhej në namaz, e pakësote namazin dhe i afrohej duke i thënë "Ake nevojë?"

73-Ai (s.a.s) gjithmonë thonte të



Shoqata

Alladi

vërtetën qoftë kur ishte në gëzim apo në zemërim.

74-Ai (s.a.s) thonte: O Zot më bëj të mjerë e më vdis ët mjerëdhe më shoqëro me të mjerët në ditën e gjykimit.

75-Nëse thonte ndonjë bisedë apo pyeste për diçka, këtë e përsëriste tri herë. Me qëllim që ta kuptonte dëgjuesi dhe pyetsi dhe që të kuptohej biseda apo pyetja tek kombi i tij.

76-Shokët e përshëndetnin duke i



Shoqata

Fladi

thënë: Emin Sabahen dhe Emin mesaen, e cila ka qenë përshëndetje e para e islamit dhe Allahut (xh.sh) zbriti ajetin.

Profeti (s.a.s) i tha shokëve të tij: Allahu e zëvendësoi përshëndetjen e mëparshme me atë të banorëve të xhennetit (Selamu alejkum).

77-Nëse harronte diçka ai (s.a.s) vendoste pëllëmbën e dorës mbi ballë dhe thonte:”O Zot, Ty të Falenderoj, O Krijues i diçkaje dhe veprues i saj, ma kujto atë që harrova.



Shoqata

Alladi

78-Ai (s.a.s) e vendoste gurin e unazën e pëllëmbës dhe e shikonte herë pas here.

79-Ai (s.a.s) nuk i takonte me dorë gratë. Nëse do të bëhej betim ai sillte një enë me ujë dhe fuste dorën e tij brenda në ujë dhe më pas e nxirrte dhe thonte: tani futini ju duart tuaja në këtë enë se kryhet betimi.

80-Prej syneve të tij ka qenë dhënia e kredisë, arijeti dhe rrespektimi i miqëve.



Shadi

81-Prej synetit të tij ka qenë thënia e shumtë: La haule uela kuete il-la bil-lah.

82-Prej synetit të tij: krehja e flohëve, prerja e thonjëve, pastrimi në sjetulla dhe pastrimi i vendeve të turpshme.

83-Prej synetit të tij: Futja në dhe e flokëve dhe e thonjeve e gjakut.

84-Para se të flinte vendoste kokuhlun.



Shoqata

Fladi

85-Ai përdorte parfume e prj atyre, miskun dhe uudin e të tjera.

86-Prej synetit të tij ka qenë vendosja e parfumit në ditën e xhuma.

87-Ai priste thonjtë dhe shkurtonte mustaqet para se të shkonte në namazin e xhumasë.

88-Prej dhuratave më të preferuara ka qenë parfumierrësirë, për këtë përdorte kandil.

89-Ai (s.a.s) ka thënë: Xhamitë janë vendet e të dërguarëve dhe prej



*Xhamitë
Alladi*

synetit është: Kur të hysh në xhami të ulesh në drejtim të kibbles.

Syneti i profetit para gjumit.

90-Para se të shkonte në shtrat ai (s.a.s) merrte abdes falte dy rekate namaz pastaj shtrihj në shtrat. Ai flinte mbi hasër.

91-Ai (s.a.s) e përbuzte të hynte në



Shoqata

Alladi

shtëpitë e nuk thuhet Bismi-lahi-
rrahmani-rrahim

92-Kur shtrihej për të fjetur ai (s.a.s)
thonte: *“O Zot me emrin Tënd
shtrihem dhe me emrin Tënd flej.”*
Dhe kur çohet nga gjumi ai thonte:
*“Falenderimet i takojnë vetëm
Allahut i cili më ngjalli dhe tek Ai do
të shkojmë.”*

93-Kur zgjohej nga gjumi i bëntë
sexhde Allahut.

94-Prej synetit të tij janë: Abdesi,
vendosja e kokës mbi dorën e djatht,



Shirazi
Alladi

të bëhet tesbih, 33 herë subhanallah, 33herë elhamdulillah dhe 33herë Allahu ekber, fytyra të jetë e drejtuar nga kibleja, leximi i sures Fatiha, ajeti i Kursijut si dhe ajeti: Shehide Allahu en-nehu la ilahe il-la hue uel melaiketu ue ulal ilm, Kaimen bil Kisti, La ilahe il-la huve el azizul Hakim.”(Suretu Ali Imranë 18).

96-Prej synetit të profetit Muhamed ka qenë namazi i natës.



Shoqata

Alladi

Syneti i profetit në martesë dhe fëmijët.

97-Profeti (s.a.s) thonte: Kush don të ndjekë synetin tim, ska dyshim se martesë është prej synetit tim.

98-

99-Profeti (s.a.s) ka thënë: Ibrahim (a.s) ka qenë xheloz dhe unë jam më tepër sesa ai.



*Shoqata
Alladi*

100-Transmetohet nga historia e Profetit Musa (a.s) se ai i tha një gruaje: “Ec pas meje dhe më oriento rrugën sepse ne jemi komb që nuk i shikojmë femrat nga prapa.”

101-Transmetohet nga Profeti (s.a.s) se ai i kërkoi mbështetje Allahut prej bashkëshortes e cila më thinjos para se të vijë koha e thinjosjes.

102- Nëse na lindë djalë ta quajmë Muhamed dhe kur të kalojnë shtatë ditë nga lindja, nëse duam ia ndërrojmë e nëse nuk dëshirojmë



Alladi

nuk e ndryshojmë atë emër.

103- Kur Profeti zgjohej në mëngjes vendoste dorën mbi kokën e fëmijve të tij dhe fëmijës së fëmijve duke i përkëdhelur.

104- Prej synetit të respektit është që një person të mbartë kunien e babait të vet.

105- Prej synetit është që nëse lind djalë të veprohet:

a- Vendosja e emrave të përsosur siç janë: Abdurrahman, Abdulgafur...m ose emrat e profetëve dhe të të përzgjedhurve.



*Shaykh
Alladi*

b- Qethja e flokëve.

c- bërja sunet ose siç quhet ndryshe pastrim.

d- Akiku për atë fëmijë, dash, dele, deve, etj...

106- Prej synetit të Profetit është që fëmijve t`u mësohet namazi dhe agjërimi, edhe sikur të agjërojnë gjysmën e ditës.

107- Kur familjen e tij e kapte varfëria ai i thonte atyre: “Çohuni në namaz” sepse për këtë më ka urdhëruar Zoti im. Taha 132.



Shahada
Alladi

108- Profeti (s.a.s) ka thënë: “ Ilaç më i mirë për shërim është uji i shiut. Para se të një person ta pijë atë ujë të lexojë shtatë dhjetë herë Suren Nas, shtatëdhjetë herë Suren Felek, shtatëdhjetë herë të bie në salavat, shtatë dhjetë herë të thuhet Subhanallah. Ky ujë të pihet në mëngjes dhe në darkë për shtatë ditë me radhë.

Syneti i sofrës

109- Ai (s.a.s) hante ushqim të njëjtë si ai i shërbyesve.



*Shaykh
Alladi*

110- Kur ulej në sofër ai ulej si shërbyesit dukeu mbështetur mbi këmbën e majtë.

111- Ai lëpinte gishtat gjatë ngrënies.

112- Ai e fillonte ushqimin me hurmë arabie (temër).

113- Ai hante me familjen dhe shërbyesit me përjashtim kur kishte ndonjë mik, sepse Profeti ulej me mikun.



Alladi

114- Ai kënaqej kur ndodheshin shumë duar në sofër.

115- Ai (s.a.s) në çdo dy kafshata falenderonte Allahun (xh.sh).

116- Kur hante iftar tek të tjerët ai thoshte: “Tek ju hëngrën agjeruesit, me ushqimin tuaj u ushqyen ebrarët dhe i`u bekuan akhjarët.”

117- Kur Ai (s.a.s) pinte ujë merrte frymë tri herë dhe në çdo ndërprerje thoshte “Bismilah” në fillim dhe “Elhamdul-lilah kur



Alladi

mbaronte nuk merrte frymë gjatë
pirjes, por ai e largonte enën dhe
pastaj merrte frymë.

118- Ai (s.a.s) nuk pinte ujë me
nxitim.

119- Ai (s.a.s) hante çdo gjë që
ndodhej (Kjo është fakt i bindjes,
madhësisë së mirësisë dhe i
falenderimit).

120- Atij (s.a.s) i pëlqente mjalti.
Rrushin e hante kokrra kokrra,
hante hurma me ujë, hante shegë,
hante mikte(e ngjashme me



Shamata
Alladi

kastravecín), etj...

121- Ai (s.a.s) e pëlqente shumë temrin (hurmë arabie).

122- Kur fillonte së ngrëni thoshte “ Bismilah”.

123- Ai nuk e përbuzte ushqimin. Nëse i pëlqente e hante dhe nëse nuk i pëlqente nuk e hante dhe nuk ia ndalonte tjerëve, sepse ndoshta ndodhej ndonjë person që e pëlqente atë ushqim.

124- Kur mbaronte së ngrëni ai



Shoqata

Fladi

lëpinte tre gishtat *(si respekt për mirësinë)*.

125- Ai (s.a.s) nuk e hante ushqimin kur ishte i nxehtë, por priste deri sa të ftohej.

126- Kur maronte së ngrëni, ai (s.a.s) lante duart.

127- Prej synetit të profetit (s.a.s) rreth sofrës janë:

a- Avdesi para ngrënies.

b- Ulja mbi këmbën e majtë.

c- Ngrënia me tre gishta.

d- Larja e duarve para dhe pas

ngrënies.

e- Vendosja e zarzavateve në sofër.

128- Profeti (s.a.s) ka thënë: “ Sikur një besimtar do të më ftonte për të ngrënë këmbët edashit do të shkoja sepse kjo është prej fesë. Nëse ndonjë mushrik apo hipokrit do të ftojë për të ngrënë mish deveje apo mish dele, nuk do ta panoja, sepse edhe kjo është prej fesë.



Shoqata

Fladi

Syneti i Profetit në xhenaze

129- Kur Profeti (s.a.s) shikonte ndonjë puçër në trupin e tij i kërkonte mbështetje Allahut dhe i lutej Atij duke thënë: “ Nëse Allahu dëshiron ta lartësojë të paaftin e lartëson dhe nëse dëshiron ta zvogëlojë të madhin e zvogëlon.”

130- Kurshoqëronte xhenaze atë e mbulonte hidhërimi dhe fliste me veten dhe nuk fliste me të tjerët.



Alladi

131- Kur hidhërohej prej diçkaje ai mbështetej tek namazi dhe agjërimi. Kur i ndodhte ndonjë fatkeqësi, ai çohet merrte avdes dhe falte dy rekatë namaz dhe i lutej Allahut duke thënë: “O Zot! Ti veprove atë që na e caktove dhe na jep atë që na e premtove.”

132- Prej synetit është që kur të varroset një femër, mos hyjë tjetërkush me përjashtim të një afërmi të saj.

133- Prej synetit është qëvarri të



Shoqata

Alladi

jetë rreth dhjetë cm. i lartë.

134- Prej syneti është përgatitja e ushqimit për familjen e të vdekurit për tri ditë me radhë.

Syneti i Profetit në namaz

Shoqata

135- Prej synetit është përdorimi i

Alladi

misvakut.

136- Kur hynte koha e namazit, Profeti (s.a.s) në atë kohë nuk njihte as familjen e as shokët e tij.

137- Kur Profeti (s.a.s) falej, ai dukej si një rrobë e hedhur prej frikës ndaj Allahut dhe asgjë nuk lëvizte prej tij me përjshtim të asaj që e lëvizte era.

138- Ai (s.a.s) nuk e vononte faljen e namazit të akshamit, por e falte në kohën e tij (kur perëndonte dielli).



Alladi

139- Kur falte namaz me xhemat Ai (s.a.s) këshillonte që të drejtoheshin rreshtat duke thënë: “ Barazohuni e mos ndryshoni sepse do të ndryshojnë zemrat tuaja.”

140- Kur dëgjonte një fëmi duke qarë, Profeti e falte më shpejt namazin që nëna e fëmisë të shkonte tek ai.

Syneti i Profetit në udhëtim

141- Kur profeti (s.a.s) udhëtonte merrte me vete pasqyrë, misvak, prerëse, krëhër, shishe parfumi, gjilpërë dhe fije.



Alladi

142- Kur kalonte në një rrygë nuk kthehej në atë, por merrte rrugë tjetër.

143- Kur profeti ishte në udhëtim nëse rrëzohej thoshte “Subhanallah” dhe kur ngrihej thoshte “Allahu Ekber.”

144- Profeti (s.a.s) nuk dilte nga shtëpia, nëse do të udhëtonte, para se të falte dyrekatë namaz. Po ashtu kur pushonte nuk nisej pa flur dy rekatë namaz në atë vendpushimi.



Alladi

145- Kur përcillte besimtarët ai lutej që të udhëtonin të sigurtë dhe të ktheheshin shëndoshë e mirë. Ndër thëniet e tij ishte:” Allahu iu furnizoftë me devotshmëri, iu drejtoftë për ngë e mira, iu plotësoftë nevojat tuaja, iu sel-limu fenë dhe jetën tuaj dhe iu ktheftë shëndoshë e mirë tek unë.”

146- Profeti (s.a.s) e përbuzte që një person të udhëtojë i pashoqëruar...
Prej synetit është që udhëtarët të marrin me vete shpenzimet e tyre.

147- Prej syneti është që kur të hyet



Shoqata

Alladi

në tulet të hyhet me këmbën e
majtë, të mbulohet koka.

Syneti i Profetit në veshjembathje

148- Shumica e veshjeve të Profetit
kanë qenë me ngjyrë të bardhë dhe
i pëlqente ngjyra e gjelbërt.

149- Profeti (s.a.s) e inkurajonte
ummetin e tij për pastërti dhe i
urdhëronte ata për të.

150- Profeti (s.a.s) ka mbante disa
unaza të gdhendura: tek njëra ishte
gdhendur “Muhamedun
Resulullah”, tek tejtra “Lailahe Il-



Alladi

lallah Muhamedun Resulullah” dhe në një tjetër “Sadekallah”. Ai i vishte unazat në dorën e djathtë.

151- Prej syneti është që këpuca e djathtë të vishet para këpucës së majtë dhe të kur të zhvishen të zhvishet e majta para të djathtës.

152- Profeti (s.a.s) e përbuzte ngjyrën e zezë përveçse tek tri veshje: çallma, këpucët dhe xhybeja.

153- Profeti (s.a.s) kishte rroba të veçanta për ditën e Xhuma. Në këtë ditë ai zbukurohej, sepse ajo ditë



Alladi

është festë, prandaj ai e veçonte
këtë ditë prej ditëve të tjera.

Përmbajtja

Parathënie.....

Kush është Muhamedi

(s.a.s)?.....



Hoxata

Fladi

Profeti Muhamed, mëshirë për
krijesat.....

Ditëlindja e Profetit Muhamed
(s.a.s) dita e unitetit
islam.....

.....

Syneti i Profetit në mardhëniet
shoqërore..

Syneti i profetit para
gjumit.....

Syneti i profetit në martesë dhe
fëmijët.....

Syneti i
sofrës.....

Syneti i Profetit në
xhenaze.....



Shaqata

Alladi

Syneti i Profetit në
namaz.....

Syneti i Profetit në
udhëtim.....

Syneti i Profetit në veshjembathje...



Shoqata

Fladi